



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **18.02.2020**, me fillim në ora **10.00**.
Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes juve delegatë të nderuar të pranishëm në këtë mbledhje të KPF-së, monitoruesit e OSBE-së, gazetarët, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Të nderuar anëtarë të KPF-së, më rastin e vdekjes të profesorit të nderuar z. Kadri Dellova i cili ka qenë edhe asambleistë në mandatin e kaluar, ju ftoj që ta nderojmë me një minutë heshtje. I përjetshëm kujtimi për profesorin e nderuar!

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozojmë këtë rend dite:

REND DITE

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Shqyrtimi i Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe Bashkisë së Vlorës së Republikës së Shqipërisë,**
3. **Shqyrtimi i Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe Komunës Civita të Republikës së Italisë,**
4. **Shqyrtimi i Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe Komunës Frascineto të Republikës së Italisë,**
5. **Shqyrtimi i Memorandum mirëkuptimit për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të strehimores “Shtëpia e sigurtë” për periudhën 3 vjeçare 2020-2022,**
6. **Shqyrtimi i Planit të Prokurimit për vitin 2020,**
7. **Shqyrtimi i plotësim ndryshimit të vendimit të datës 16.02.2018 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi,**
8. **Të ndryshme.**

Kryesuesi – E vë në votim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës: Kalohet në pikën e parë të rendit të ditës:

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për juve, anëtarët e KPF-së, për drejtorët, përfaqësuesit e LMT-së, OSBE-së, mediave edhe të gjithë të pranishmit në sallë. Unë desha një korigjim ndoshta është lëshim i rastit në faqe 10, te diskutimi imi që është bërë sigurisht lëshim i rastit kur kemi diskutuar për këtë pikë të rendit të ditës, unë kam thënë për lëshimet apo gabimet aritmetikore ose matematikore pasi janë sinonime, kurse këtu po shkruan alejtikore pra këtë fjalë alejtikore me zëvendësua me aritmetikore edhe në rreshtin e gjashtë po ashtu edhe në rreshtin e shtatë gabime aritmetikore dhe po ashtu në rreshtin e nëntë gjithashtu e kemi lëshime që duhet të bëhet gabime aritmetikore, kjo ishte ajo se për çka deshta me than.

Kryesuesi – Faleminderit z.Fazliu, atëherë nëse nuk ka tjerë të lajmëruar, mendoj që sekretaria do t'i përmirësojë këto gabime. E qesim në votim pikën e parë të rendit të ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalohet në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe Bashkisë së Vlorës të Republikës së Shqipërisë.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, përshëndetje për juve, për kolegët këshilltarë, monitoruesit e OSBE-se, KFOR-it dhe gjithë ju të pranishëm në sallë. Mendoj se këto 3 pika të rendit të ditës pra e 2,3 dhe 4 kanë të bëjnë me marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet komunës tonë dhe 3 komunave tjera që ne më herët i kemi aprovuar kërkesën e kryetarit që ka kaluar përmes Kuvendit që të bëhet binjakëzimi i Komunës tonë me tri komuna, pra është fjala me Bashkinë e Vlorës edhe dy komunat nga Italia Civita dhe Frascineto. Jemi në pikërisht ata që kemi kërkuar që të bëhet një formë e marrëveshjes ose memorandumit të bashkëpunimit ose një projekt propozim që duhet të kalojë në Kuvendë në mënyrë që Komuna jone si këshilltar se në çfarë fusha do të bashkëpunojmë sepse mendoj se kjo është me rëndësi jo vetëm binjakëzim thjesht por të gjejmë ato fusha ku ne mund të bashkëpunojmë dhe ato të jenë të dobishme në mënyrë bilaterale sigurisht edhe për komunën tonë, kështu që mendoj me këto marrëveshje të bashkëpunimit janë të përfshira edhe ato elemente kryesore natyrisht në të ardhmen do të shikohet ndoshta edhe ndonjë fushë tjetër që do të lind gjatë kohës së bashkëpunimit që ne mundemi si komunë me bashkëpunua kështu që unë mendoj se është në rregull dhe pajtohem që kjo pikë e rendit të ditës dhe nëse pajtoheni edhe këshilltarët tjerë nga KPF-ja që këto 3 pika të rendit të ditës që janë të njëjta pra të ngjashme të kalojnë për Kuvend dhe atje ne do të mundemi të japim kontributin tonë bashke me delegatët e tjerë për shqyrtim.

Kryesuesi – Faleminderit shumë z.Cena, të nderuar anëtarë a po pajtoheni që të tri pikat të kalojnë për Kuvend. Konstatojmë që pika 2,3 dhe 4 kalojnë për Kuvend. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Memorandumit të mirëkuptimit për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të strehimores “Shtëpia e sigurte” për periudhën 3 vjeçare 2020-2022.

Fehmi Cena – Sa po mundemi të kuptojmë ne, Memorandumi i mirëkuptimit, është fjala në këtë rast për “Shtëpinë e sigurte” apo një strehimore ku do të strehohen përkohësisht viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit të qenies njerëzore duke përfshirë edhe komunën tonë pra është fjala për një strehimore në nivele regjional që përfshin 3 komunat. Unë kam një pyetje që po me intereson në të kaluarën se a ka a pasur Komuna jonë obligime buxhetore pra detyrime buxhetore për këtë shtëpi apo është hera e parë? Sa e di unë kjo shtëpi ka ekzistuar edhe më përpara por nuk kam njohuri se a ka ekzistuar marrëveshje më përpara. Pastaj desha me bë disa ndërhyrje pra përmirësime teknike në mënyrë që në mbledhjen e Kuvendit të jenë këto përmirësime, te neni 2 pika 1, rreshti i tretë ku thuhet si dhe viktimat e përkohshme të qenieve njerëzore pra le të ekzistoj e përkohshme të trafikimit pasi tjetër kuptim ka ajo d.m.th. viktimat e përkohshme të trafikimit të qenieve njerëzore. Në faqen 2, pika 3 ku thuhet se në rast se ndonjëra nga palët nënshkruese nuk dorëzon një njoftim tjetër deri datën e përfundimit të këtij memorandumit dhe pikë pra këtu duhet të jetë presje pasi jep kuptimin tjetër.

Florida Bajraktari – Faleminderit kryesues, ndoshta veç me pyet te kjo marrëveshje mirëkuptimi për mbulimin e shpenzimeve që lidhet ndërmjet Komunës dhe “Shtëpisë së sigurte”, desha me ditë se sa kohë ka që funksionon kjo, sa e ka kapacitetin dhe stafin që punon aty dhe me ditë lokacionin në Gjakovë konkretisht se ku gjendet kjo.

Kryesuesi – Faleminderit zj. Bajraktari, atëherë sa i përket pyetjes që e adresoj z. Cena, mendoj që është për herë të parë që lidhet marrëveshja me këtë, atëherë pasi nuk kemi tjetër të lajmëruar, konstatojmë se kalon për Kuvend edhe pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i Planit të Prokurimit për vitin 2020.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, desha të pyes se ku janë drejtorët me intereson me dit, pse nuk është asnjëri prezent? Unë së pari do të ndalem te dokumenti në faqen e parë, meqenëse ky ka me shkua edhe në Kuvend pra është mirë të shkoj pa gabime, kjo i adresohet edhe kryetarit, i nderuari kryetar këtu kemi disa gabime që unë po i përmendi vetëm dy p.sh. të bashkangjitur keni planifikimin të prokurimit pra duhet me than planifikimin e prokurimit për vitin 2020 pastaj planifikimi është pregaditur që mendoj se është e shkruar keq dhe duhet të përmirësohet dhe të bëhet përgatitur, pra ka edhe gabime tjera por unë besoj që ai që e merr me korrigjua duhet të korrigjon krejt dhe unë s’po dua me tepër të ju marr kohë, pra duhet të korrigjon edhe pse kemi evidentuar disa (ë), po ashtu edhe disa nuk i keni vënë hiq dhe i keni lënë (e), kështu që është mirë me i përmirësuar në përgjithësi pasi s’po dua me shkua në detaje. Faleminderit shumë!

Fehmi Cena – Në këtë material të planifikimit të Prokurimit për vitin 2020 janë të përshkruara kontratat që kanë me u bërë qartë mirëpo për shëndetësinë nuk kam vërejtur ndonjë prokurim që do të bëhet sidomos për furnizimet, përmendet diku në faqe e 4 furnizimi me material teknik 80,000 euro që nuk e di a përfshihet për shëndetësi pasi shëndetësia ka nevojë për furnizime për disa materiale që janë shpenzuese p.sh. reagenat për laborator, filma për rentgen që ndodh gjatë vitit edhe me pas probleme për disa javë që ndonjëherë mungojnë reagenca, filma prandaj desha me pas disa sqarime me të saktë pasi këta të prokurimit nuk po prezantojnë askush këtu, kisha dashur me dit se a është kjo apo është kryer më herët në mënyrë që me ditë në të ardhmen se a do të kemi probleme pasi nuk po shoh, te fusha e shëndetësisë furnizimet nuk po i shoh pasi mungojnë, nuk e kam të qartë pse, prandaj kisha deshtë një sqarim në këtë drejtim. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Cena, atëherë pasi nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatojmë se kalon për Kuvend pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i plotësim ndryshimit të vendimit të datës 16.02.2018 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, më herët anëtari i Këshillit të KKSB-së i cili ka qenë komandant i Policisë z. Osman Ismaili, tani është ndërruar Komandanti i Policisë të stacionit policor në Rahovec dhe tani është z. Fazli Morina, pra neve na nevojitet vetëm plotësim ndryshimi i emrit.

Te nderuar anëtare të KPF-së, konstatoj se dhe pika e shtatë e rendit të ditës kalon për Kuvend. Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës: **Të ndryshme.**

A ka dikush diçka për këtë pikë, nëse jo atëherë unë kam një propozim që për mbledhje të Kuvendit, jemi në shqyrtim të rregullores në nivele komunal për taksa, e cila po punohet edhe në komunën tonë mirëpo për mbledhje të KPF-së nuk kanë mundur me përgatitë edhe na duhet që për mbledhje të Kuvendit vetëm të aprovojme për dalje në debat publik Rregullorja për taksa pra nëse edhe ju pajtoheni që ta kemi edhe në mbledhje këtë pikë shtesë.

Rasim Fazliu – Faleminderit, ju përshëndes edhe nënkryetarin që erdhi, nëse ju përgatiteni për mbledhje të Kuvendit me Rregullore, ne me siguri se do ta trajtojmë atë. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Fazliu, ka qenë kërkesë e asambleistit z. Rexhep Oruqi që në një mbledhje të vij edhe të na jep informata edhe komandanti i policisë për vitin 2019 z. Fazli Morina apo një raport. Nëse pajtoheni që ta kemi për këtë mbledhje edhe këtë informatë nga Komandanti i Policisë.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, nëse ai e parasheh që mundet me ardhë me raportua rreth punës së policisë, ai mundet me ardh pasi ne jemi të gatshëm edhe pikat e rendit të ditës nuk janë të ngarkuara aq shumë pasi s'kemi edhe material shumë, sigurisht nëse edhe kolegët pajtohen. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit z.Fazliu, po komandanti është i gatshëm me raportuar pasi edhe muajin e kaluar e ka sjellë raportin mirëpo kemi pasur mbledhje shumë të ngarkuar.

Fehmi Cena – Me sa e di unë, në dhjetor e kemi shqyrtuar raportin e KKSB-së për vitin 2019 dhe vetëm nëse ka diçka të veçantë pasi është edhe kërkesa e z. Oruqi ndoshta ka diçka të veçantë atëherë pajtohem, sigurisht edhe komandanti nëse e sheh të arsyeshme se ka diçka të veçantë rreth çështjes se sigurisë për vitin 2019 atëherë pajtohem sigurisht.

Fatmir Iska – Faleminderit shumë kryesues, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politike dhe Financa, unë vetëm dua me kërkua falje që nuk kemi qenë prezent sot këtu pothuajse asnjëri, gjithë e dimë që kemi aktivitete edhe sot pra sinqerisht edhe njëherë kërkoj falje, pastaj do të jemi bashkë në Kuvend, ndërsa për këtë është raporti i Policisë është traditë edhe në mandatin e kaluar ishte raportimi i KKSB-së pasi raporti është diçka tjetër kurse ky i Komandantit të Policisë është diçka tjetër.

Kryesuesi – Faleminderit shumë nënkryetar, të nderuar anëtarë të KPF-së faleminderit shumë për kontributin dhe vazhdojmë me ceremoninë e ish kolegut Kadri Dellova. Faleminderit shumë!

Mbledhja përfundoi në 10:35

Procesmbajtësi,


Agim Hoti

